
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

FORCIMI I EFIÇENCËS DHE CILËSISË SË SISTEMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI (SEJ III)

Detyrimet Raportuese për Statistika Gjyqësore

Beqiraj – Gugu Bushati

Maj 2020

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Indeksi

1. Lista e shkurtimeve	3
2. Metodologjia, synimi dhe qëllimi.....	3
Tabela e Detyrimeve Raportuese për Statistika Gjyqësore	6

1. Lista e shkurtimeve

CEPEJ	Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë
KiE	Këshilli i Evropës
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MD	Ministria e Drejtësisë
GJL	Gjykata e Lartë

2. Metodologjia, synimi dhe qëllimi

Programi i Këshillit të Evropës/Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ) po zbaton fazën e tretë të projektit “Forcimi i Efiçencës dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ III), i cili është pjesë e programit me titull Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” (HF II), i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Këshilli i Evropës (KiE).

Një nga prioritetet kryesore të SEJ III është që të asistojë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KL Gj) për të vënë në zbatim kuadrin e ri legjislativ sipas standardeve dhe mjeteve të CEPEJ. Në këtë aspekt, një ekip ekspertësh ndërkombëtarë të CEPEJ (Julinda Beqiraj, Harold Epineuse dhe Georg Stawa), të mbështetur nga ekipi lokal i CEPEJ/SEJ, kryen një vlerësim të situatës dhe problemeve aktuale që lidhen me mbledhjen e statistikave gjyqësore me qëllim ofrimin e rekomandimeve për një qasje më konsistente ndaj mbledhjes së statistikave gjyqësore në përputhje me Udhëzimet e CEPEJ/SATURN dhe me standarde të tjera relevante që do të duhet të përshtaten sipas nevojave të Shqipërisë.

Raporti i ekspertëve të CEPEJ (si rezultat i këtij vlerësimi) i marsit 2020 “Mbledhja e të dhënave, Menaxhimi i Çështjeve dhe Strategjia IT në Shqipëri” konstatoi se mbledhja e të dhënave bëhet me kërkesë dhe se gjykatat dhe departamentet e tyre të statistikave janë të mbingarkuara dhe nuk e kanë tablonë e madhe të qëllimit të mbledhjes së të dhënave. Mes hapave të ndërmarrë, raporti i ekspertëve sugjeron kryerjen e një hartëzimi të detyrimeve raportuese/kërkesave që trajtohen nga gjykatat, qoftë përmes KL Gj-së, institucioneve të tjera apo në nivel gjykate. Pikërisht ky hap është ndërmarr në procesin aktual.



Ky dokument ofron një hartëzim të detyrimeve raportuese për statistika gjyqësore. Ai mbështetet në studimet e bëra nga zyra, të cilat u kryen nga ekspertët e CEPEJ Julinda Beqiraj dhe Aida Gugu Bushati, si dhe mbi asistencën e herë pas hershme nga përfituesit vendas, të cilët shkëmbyen dokumente të vlefshme dhe bënë një lloj vlerësimi të informacioneve – specifikisht, anëtarët e përzgjedhur të KLGj-së dhe stafit teknik që punon me statistika gjyqësore, korrespondenti i CEPEJ dhe përfaqësuesit e departamentit të statistikave të Ministrisë së Drejtësisë.

1. Përmbledhje e Detyrimeve Raportuese për Statistikat Gjyqësore

Ky proces kishte për qëllim të qartësonte dhe të saktësonte kërkesat për raportim të statistikave gjyqësore që përbëjnë një ngarkesë për gjykatat (sidomos për kancelarët dhe seksionet e statistikave); kjo mund të çonte në uljen e barrës së departamenteve të statistikave në nivel gjykate, të garantonte koherencë dhe të shmangte mbivendosjen.

Në varësi të natyrës së tyre, të dhënat gjyqësore mund të kualifikohen si të dhëna për përdorim publik ose të dhëna për përdorim të brendshëm të gjykatave/institucioneve. Ndonëse institucionet raportuese mund të variojnë (Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj), Ministria e Drejtësisë (MD), Gjykatat), të dhënat prodhohen pikë së pari në nivel gjykate, nga Kancelari ose nga Kryetari i Gjykatës. Institucionet raportuese përdorin formularë të ndryshëm raportimi, të cilët përmbajnë kategori të ndryshme informacioni; kjo justifikohet pjesërisht me qëllimin e raportimit apo me metodologjinë specifike të përdorur nga institucioni apo nga Organizata Ndërkombëtare përkatëse. Megjithatë, institucionet që bëjnë kërkesat duhet të vënë në dispozicion formate të standardizuara për raportimin e të dhënave statistikore gjyqësore sa më shumë që të jetë e mundur, duke dhënë edhe orientime shpjeguese mbi kategoritë e të dhënave që duhet të raportohen.

Në tabelën më poshtë paraqitet një përmbledhje e detyrimeve raportuese për statistika gjyqësore. Këto detyrime raportuese janë të parashikuara me ligj ose rrjedhin nga anëtarësimi i Shqipërisë apo shkëmbimet e saj me Organizatat Ndërkombëtare. Në këtë tabelë ofrohet informacion për: institucionet përgjegjëse për të raportuar sipas ligjit; institucionet të cilave u drejtohen këto kërkesa (duke përfshirë nëse raporti duhet apo jo të vihet në dispozicion të publikut të gjerë); shpeshtësinë e raportimit; bazën ligjore; qëllimin; përmbledhjen e kategorive kryesore të informacionit që përmban/që analizon raportimi; si dhe nëse ekzistojnë rregullore, udhëzime apo formate të standardizuara.

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Në vazhdim do të bëhet edhe një analizë e hollësishme e përmbajtjes së raportimeve për statistika gjyqësore të renditura më poshtë, rëndësinë e tyre, mbivendosjet e mundshme dhe qëllimin e raportimit.

Tabela e Detyrimeve Raportuese për Statistika Gjyqësore

	OFRUESI(T) PËRGJEGJËS	INSTITUCIO NI TW CILIT I DREJTOHET KWRKESA	EMRI I RAPORTIT	SHPESHTW SIA	BAZA LIGJORE	QËLLIMI	PËRMBLEDHJA E KATEGORIVE TË INFORMACIONIT	RREGULLORE/ UDHËZUES/F ORMAT I STANDARDIZ UAR
1.	KLJGJ Kryetari i KLJGJ-së	Publik; Parlament	Raporti mbi numrin e çështjeve dhe ngarkesën e gjykatave 2018 AL EN	Vjetor (jo më vonë se 1 maj)	<ul style="list-style-type: none"> • Nenet 81 dhe 82, Ligji 115/2016 për Institucionet Qeverisëse të Sistemit Gjyqësor • Neni 59.3(dh), Ligji 115/2016 për Institucionet Qeverisëse të Sistemit Gjyqësor • Neni 22, Ligji 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor 	Vlerësimi i veprimtarisë së KLJGJ-së dhe performancës gjyqësore.	<u>Raporti i KLJGJ-së, Seksioni 4</u> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i çështjeve dhe çështjet e prapambetura në nivel kombëtar • Çështjet e reja • Çështjet e prapambetura • Çështjet e zgjidhura 	Nr.

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

							<ul style="list-style-type: none">• Nr. i gjyqtarëve sipas Gjykatës• Koha e disponimit (DT)• Raporti i qarkullimit të çështjeve (CTR)• Norma e zgjidhjes në % (CR)• Burimet Buxhetore• Situata në Gjykatën e Lartë• Arsyet e vonesave në paraqitjen e vendimeve gjyqësore	
--	--	--	--	--	--	--	---	--

2.	MD	INSTAT/Publiku i gjerë	Raporti Vjetor i Statistikave 2018 AL	Vjetor	<p><i>Ligji për statistikat zyrtare, nr. 17/2018, Shtojca 1, 1.7 Drejtësia dhe Kriminaliteti, Neni 10.</i></p> <p>Neni 6, pika 15, Ligji për Ministrinë e Drejtësisë, nr. 8678, datë 14/5/2001, i ndryshuar</p>	Analizë e unifikuar e sistemit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> • Statistikat për Çështjet Penale dhe Civile të shqyrtuara nga gjykatat e rretheve • Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve • Shpërndarja e Shkallës së Kriminalitetit për vitin 2018 sipas Çështjeve të Mbyllura Penale • Çështje të gjykuara për korrupsion dhe krim të organizuar • Çështje të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë sipas Kodit Penal Ushtarak • Krimet nga të miturit 	<p>Udhëzimi Nr. 4, datë 15/04/2019</p>
----	----	------------------------	---	--------	---	---	---	--

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

							<ul style="list-style-type: none">• Pezullimi i zbatimit të dënimit dhe vendosja e një dënimi alternativ dhe monitorimit elektronik• Ngarkesa e punës së gjyqtarëve për vitin përkatës• Analizë krahasuese për Apelet Civile të shqyrtuara nga Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë• Statistikat për procedimet penale dhe dinamikat e tyre në Prokurori	
--	--	--	--	--	--	--	--	--



3.	MD	CEPEJ - KiE	Vlerësimi i CEPEJ - të dhënat dhe raportet sipas vendeve	Çdo dy vjet	Shqipëria u bë pjesë e KiE-s më 13 korrik 1995; mori pjesë në vlerësimin e parë të ÇEPEJ në vitin 2001.	Vlerësimi i performancës së sistemit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> • Burimet Buxhetore • Gjyqtarët, prokurorët dhe stafi • Gjykatat • Treguesit e efijencës 	<ul style="list-style-type: none"> • KiE Pyetësor (2018) • KiE Shënim shpjegues (2018) • KiE Dosje për korresponden cën kombëtare
4.	MD	CEPEJ - KiE	Tabelë për Ballkanin Perëndimor	Vjetor	Program i i nisur 2019-2022	Vlerësimi i performancës së gjyqësorit		<ul style="list-style-type: none"> • KiE Pyetësor 2018 • Shënim shpjegues 2018 (KiE)

5.	MD	Të ndryshme për Org. Ndërkombëtare (BB/BE)	<ul style="list-style-type: none"> • Historiku - Korrupsioni dhe krimi i organizuar • Historiku i deklarimit të aseteve • Çështjet e pastrimit të parave • Çështjet penale – shkelja e pronësisë intelektuale 	<p>Tremujore/ Vjetor</p> <p>Vjetor</p> <p>Gashtë- mujore/vjet ore</p> <p>Vjetor</p>		Gjendja e korrupsionit dhe krimin të organizuar	<p>Të dhëna për: korrupsionin dhe krimin e organizuar; përgjegjësia penale dhe çështjet e deklarimit të pasurive; pastrimi i parave; shkeljet e pronësisë intelektuale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacione për çështjet e gjykuara • Sanksionet e vendosura nga gjykatat • Nr. i personave të dënuar/sanksionuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 804/1 i MD-së, datë 23/12/2013 mbi mbledhjen dhe përpunimin e statistikave për korrupsionin dhe krimin e organizuar • Nr. - bazuar në kërkesën e Org. Ndërkombëtare • Nr. - bazuar në kërkesën e Org.
----	----	--	---	---	--	---	---	--

								Ndërkombëtare
6.	Gjykatat/Kryetar	KLJG	Raporti mbi personelin gjyqësor dhe nr. e çështjeve	Tremujor	<ul style="list-style-type: none"> Neni 37, Ligji 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor Vendimi i KLGj-së Nr. 25, datë 7/2019 Mbi informacionin periodik të dhënë nga kryetari i Gjykatës mbi performancën e gjykatës 	Vlerësimi i performancës së gjykatës dhe gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> Çështjet e reja për gjykatë dhe për gjyqtar Çështjet e prapambetura Nr. i çështjeve që kanë tejkaluar kohëzgjatjen e arsyeshme (neni 399 i Kodit të Proced. Civile) Tërheqja e gjyqtarëve Probleme me menaxhimin e çështjeve, prodhimin e statistikave 	Tabela të gatshme për raportim

7.	KLGJ	Publiku në tërësi	Raport për vlerësimin e gjyqtarëve	Vjetor dhe çdo tre vjet Deri në fund të marsit të vitit pasues	Neni 98, 99, Ligji 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve	Pasqyrë e procesit të vlerësimit dhe rezultatet	Raporti tre-vjeçar: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim i përgjithshëm i vlerësimit të bërë • Analizë e rezultateve të vlerësimit për të identifikuar dobësitë dhe pikat e forta • Rekomandime për masat që duhet të merren për të kapërcyer dobësitë e identifikuar • Analiza e efikasitetit të rekomandimeve për periudhën e mëparshme raportuese 	Nr.
8.	Gjykatat	KLGJ - Komiteti për etikën dhe vlerësimin e	Statistikat për gjyqtarët individualë	Çdo vit Lidhur me procesin e	Neni 77 deri 90 dhe 84, Ligji 96/2016 për Statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve	Vlerësimi i etikës dhe performancës	Të dhëna statistikore për punën e gjyqtarit lidhur me:	<ul style="list-style-type: none"> • Vendimi i KLGJ-së Nr. 264, datë



		performancës		vlerësimin të etikës dhe performancës (çdo tre vjet gjatë 15 viteve të para të punës; një herë në pesë vjet pas 15 vjetësh pune)			<ul style="list-style-type: none"> Nr. e çështjeve si gjyqtar i vetëm ose raportues në një panel, sipas kategorive Nr. i çështjeve si gjyqtar i deleguar Respektimi i afateve kohore të procesit gjyqësor Respektimi i afateve ligjore CR (Norma e likuidimit) sipas kategorisë Numri mesatar i seancave 	<p>21/11/2019 Për miratimin e "Metodologjisë së vlerësimit me synim përcaktimin e vlerësimit të gjyqtarit"</p> <ul style="list-style-type: none"> Vendimi i KLGJ-së Nr. 60, datë 30/01/2020 Për miratimin e udhëzimeve orientuese "Për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore me qëllim vlerësimin etik dhe
--	--	--------------	--	--	--	--	--	--

								profesional të gjyqtarëve".
9.	Gjykata	KLJG	Kryetari i gjykatës	Çdo vit - Lidhur me vlerësimin profesional të Kryetarit Një herë gjatë mandatit të së paku gjashtë muaj përpara përfundimit të tij	Neni 79 ff dhe 84, Ligji 96/2016 për Statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve	Vlerësimi i vlerësimit të performancës	Të dhëna statistikore për funksionimin e gjykatës për 5 vjet.	Aktet nënligjore që nuk janë hartuar ende nga KLJG-ja
10.	Kryetari / Kancelari / Takimi i	KLJG/Takimi i Përgjithshëm	Raporti vjetor i gjykatës	Çdo vit	Nenet 29,40, Ligji 98/2016 për organizatën	Vlerësimi i performancës së	Burimet njerëzore Ngarkesa e gjyqtarëve	Ende nuk është diskutuar në

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

	Përgjithshëm i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës	m i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës			e pushtetit gjyqësor në Shqipëri	përgjithshme të gjykatës	Buxheti dhe infrastruktura	kuadrin e rregullores së brendshme të gjykatave. Akti nën-ligjor nuk është miratuar ende
--	---	--------------------------------------	--	--	--	--------------------------	----------------------------	---

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe